



Titulli i projektit

Përfshirja sociale e të rinjve nëpërmjet përmirësimit të aftësive profesionale

Tipi i projektit

Zhvillim ekonomik

Vendndodhja e projektit

4 NJQV e ZF SHijak

Buxheti i paravlerësuar

400,000 Euro

Përshkrimi dhe analiza e problemit/eve

Nga analiza studimore e Zonës Funksionale Shijak rezultojnë se hapësirat e punësimit të brezit të ri janë minimale. Sektori i shërbimeve dhe zejeve është kryesisht biznes familjar, pak i zhvilluar dhe sporadik. Kjo është pasojë edhe e mungesës së fuqisë punëtore të trajnuar. Kjo situatë bën të nevojshme adresimin korrekt të çështjes së trajnimit dhe specializimit të të rinjve në përputhje me nevojat dhe hapësirat e tregut të punës. Moderimi i drejtë i kësaj marrëdhënieje, në bashkëpunim të ngushtë edhe me biznesin lokal, do të ndikonte edhe në uljen e tendencave të lëvizjeve demografike dhe migracionit.


Qëllimi/et specifik të projektit

Nëpërmjet këtij projekti synohet përmirësimi i aftësive dhe kapaciteteve profesionale të të rinjve për t'u përshtatur me kërkesat dhe tendencat e tregut të punës. Kjo sigurisht që do të bëhet në bashkëpunim të ngushtë me biznesin lokal dhe interesat e tij për krah pune të specializuar në funksion të rritjes dhe zgjerimit të prodhimit dhe do të sjellë reduktimin e fenomenit të migracionit dhe ruajtjen e strukturës së popullsisë.

Rezultatet e pritshme dhe treguesit

Të gjitha NJQV e Zonës Funksionale Shijak (katër të tilla) janë në mënyrë të barabartë të përfshira në këtë projekt. Përfituesit direkt të këtij projekti janë 100 të rinj të zonës, të cilët do të përfitojnë nga trajnimet profesionale, si dhe biznesi vendas (10 për çdo NJQV = 40 në total), që do të mbështetet me fuqi punëtore të specializuar, si dhe me teknologjinë e nevojshme për zgjerimin dhe rritjen e prodhimit. Nga ana tjetër, minimumi 40 familje do të përfitojnë nga punësimi i një anëtar, pasi bizneset e përzgjedhura për të përfutur mbështetje teknologjike do të jenë të detyruar të punësojnë të paktën një person.

PROJEKTI 3



program i zonave funksionale

pzf

Aktivitetet e projektit

- Studim mbi nevojat dhe hapësirat e biznesit lokal;
- Përzgjedhja dhe trajnimi profesional i 100 të rinjve vendas në përputhje me rezultatet e studimit;
- Mbështetje e biznesit lokal me teknologji të re në përputhje me rezultatet e studimit;
- Punësimi i të paktën 40 të rinjve dhe mbulimi i një pjese të shpenzimit;
- Krijimi i një tradite për trajnimin profesional të të rinjve në zonë;
- Promovimi, etj.

Maturimi i projektit

Ka vetëm një koncept të qartë për nevojën dhe mundësitë që do të ofronte zbatimi i këtij projekti. Për zbatimin e këtij projekti, hapi i parë që duhet të ndërmerret është marrëveshja me pushtetin vendor dhe biznesin lokal.

Burimet e financimit dhe partnerët në zbatim

Duke marrë në konsideratë pamundësitë financiare të pushtetit vendor për financimin e projekteve të kësaj natyre, do të ishte e përshtatshme që të kërkohej financim nga donatorët e huaj dhe fondet e zhvillimit të rajoneve të Qeverisë Shqiptare.

Kostot e projektit

Studim mbi nevojat dhe hapësirat e biznesit lokal	15,000
Përzgjedhja dhe trajnimi profesional i të rinjve	50,000
Mbështetje e biznesit lokal me teknologji të re	160,000
Punësimi i të paktën 40 të rinjve	50,000
Krijimi i një tradite për trajnimin profesional të të rinjve në zonë	
Promovimi	10,000